



Npi – 01/78 datë: 01.04.2020

Në bazë nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 37 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, datë:03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3.2 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/149, datë:31.05.2019, për mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, së Shtimes e mbajtur më: 01.04.2020 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S S Ë J A S H T Ë Z A K O N S H M E T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S S Ë S H T I M E S

E mbajtur më: 01.04.2020, e (mërkurë) në ora 8.30h (është shty në ora 10.00 h) në sallën e Kuvendit. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Medina Brahaj, Perparim Ramusa, Shefki Dauti, Herolind Selmani, Reshat Mujota, Arbresha Syla, Milot Deliu, Fatmire Ferati, Naim Zejna, Skender Hyseni, Zarife Rexhaj, Valentina Halili-Ferati, Ruzhdi Jashari, Besnik Seferi, Marigona Pajaziti, Fehmi Hysenaj, Adelina Beqaj, Isak Muslija, Diarta Vishesella, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi. Përveç delegatëve në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli; Drejtorët: DSHP-z.Halil Halili, DSHMS – z.Labinot Beqa; Zyrtarët e Financave, znj.Kimete Ukaj dhe z.Jetush Rrafshi, Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen, në vazhdim tha: Sot kemi thirrë mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit për arsye të përhapjes së gripit i njohur me emrin Korona-virus ose KOVID19, për këtë arsye edhe jemi detyruar që këtë mbledhje ta mbajmë në sallën e Shtëpisë së Kulturës, me qëllim që në këtë sallë ka ulëse të mjaftueshme për ta mbajtur distancën mes njëri tjetrit, ashtu siq është kërkuar nga OBSH-ja dhe Instituti i Shëndetit Publik. Sot jo vetem ne por e gjithë bota po përballet me Pandeminë (E shpallur nga Organizata Botërore e Shëndetësis) e një sëmundje që është përhapur me shpejtësi të madhe dhe po merr edhe jetra njerëzish e emërtuar si Korona-Virus ose KOVID19. Pra faktikisht gjendemi në rrethana të jashtëzakonshme, prandaj edhe e kemi thirrë këtë mbledhje të Jashtëzakonshme të Kuvendit. Kjo mbledhje është thirrë me një pikë të vetme të rendit të ditës ashtu siq e parasheh edhe LVL-ja me qëllim që të marrim një vendim për të ndarë një sasi të mjeteve financiare për të ju dalë në ndihmë edhe ekipeve mjeksore në vijën e parë të frontit por edhe për ti ndihmuar banorët e komunës tonë.

Në vazhdim Kryesuesja Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve të Kuvendit prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Propozim-Vendim për aprovimin e mjeteve financiare për shkak të Shpalljes së Gjendjes Emergjente të Shëndetit Publik.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, tha: Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë, ku është propozuar që Kuvendi ti ndanë 100,000.00€ për parandalimin e përhapjes së Korona-virusit, mirëpo dje kemi qenë në mbledhjen e radhës të Shtabit Komunal për Emergjencë, ku është propozuar që kjo shumë të dyfishohet nga 100,000.00€ në 200,000.00€ për shkak të rrezikut të kohëzgjatjes por edhe për shkak të nevojave për ndihma të familjeve që janë më në nevojë. Unë po ju informoj se duhet ta respektojmë minutazhën e diskutimit të paraparë me rregullore, edhe për faktin e gjendjes epidemiologjike në të cilën jemi, ku rreziku nga

infektimi është mjaft i madh, prandaj edhe kohën ta shfrytëzojmë sa më racionalisht. Unë po e hapi diskutimin për rendin e ditës, nëse dikush ka ndonjë vërejtje ose sygjerim, sepse siq e thash kjo mbledhje është vetëm me një pikë të rendit të ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, uroj që këtë situatë ta kalojmë sa më shpejt edhe sa më lehtë. Unë kam një propozim konkret, propozoj që Kuvendi në këtë mbledhje të merr vendim për heqjen e të gjitha taksave për bizneset e komunës tonë. Pres që ky propozim i imi të miratohet.

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje, unë e përkrahu rendin e ditës, e di që nuk lejohet futja e ndonjë pike tjetër të rendit të ditës. Sa i përket propozimit të Besnikut, unë kam propozuar që të mbajmë një mbledhje të Kuvendit On-Line, dmth. që një vendim të tillë që e propozoi Besniku ne mund ta aprovojmë edhe pa qenë prezent në mbledhje në një sallë, por mund ta organizojmë nga distanca, ashtu sikur këtyre ditëve po vepronë shumica e institucioneve me mbajtjen e takimeve, për shkak të rrezikut të përhapjes së Korona-Virusit. Unë kisha thënë që pikërisht për shkak të situatës nuk është mirë që të kufizohet minutazha e diskutimeve.

z.Isak Muslija; Përshëndetje, unë mendoj se në këtë propozim të rendit të ditës është dashur të futet edhe një pikë për të na dhënë një raport Kryetari për gjendjen në teren nga kjo pandemi.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Kryetari, do ta bën një informatë për gjendjen në teren në komunën tonë për sa i përket pandemisë, me rastin kur ta prezanton propozim-vendimin.

z.Shefki Dauti; Përshëndetje, me këtë rast dua ti përshëndes të gjithë stafin e QKMF-së dhe gjithë punëtorët shëndetësor që realisht janë në vijën e parë të frontit nga Korona-Virusi. Po ashtu respekt meritojnë edhe Policia që po bëjnë punë mjaft të vështirë, sikurse edhe punëtorët e KRM "Pastërtia" po i kryejnë punët e tyre me gjithë vështirësitë që i kanë. Prandaj duke i përshëndetur edhe të gjitha institucionet tjera ne do ta përkrahim këtë rend dite.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, por po na mungon një specifikim të mjeteve se ku do të shpenzohen ato. Po asht kemi edhe një kërkesë tjetër për një informantë me na treguar se si janë zgjedhur anëtarët e Shtabit Komunal të Emërgjencës?

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, unë jam i mendimit që këto 100,000.00€ që janë propozuar të kalojnë ndërsa pjesa tjetër, për ndonjë herë tjetër.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, jemi të shqetësuar me situatën që po kalojmë. Kjo situatë kërkon solidaritet, prandaj unë e përkrahu propozimin e Kryetarit. I falënderoj mjekët, Policët dhe të gjithë tjerët që po angazhohen në këtë situatë të gripit KOVID19.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Propozim-Vendim për aprovimin e mjeteve financiare për shkak të Shpalljes së Gjendjes Emergjente të Shëndetit Publik.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e klësaj pike fjalën ja dha z.Naim Ismajli.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Përshëndetje, tash më jeni në dijeni se jo vetem te ne por ne gjithë botën është përhapur një sëmundje me emrin Koronavirus ose KOVID19 e që është kualifikuar si Pandemi nga OBSH-ja. Ne po bëjmë përpjekje që kjo sëmundje mos të përhapet sikurse që ka ndodhur në disa vende të botës. Unë i falënderoj të gjithë ata që ndihmuan dhe që po ndihmojnë sipas deturave të tyre të punës por edhe ata që po ndihmojnë vullnetarisht, sidomos i falënderojmë punëtorët shëndetësor, policët, punëtorët e "Pastërtisë" ata të ujësjellsit "Prishtina" edhe Klubin e Biznesit për ndihmën e tyre. Unë do të përpigem që të prezantojë Propozim-Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare si dhe do të përgjigjem në disa shqetësime që u ngritën këtu nga delegatët e Kuvendit. Sa i përket Propozim-Vendimit, bazën ligjore e ka te Ligji për Financat Publike dhe Ligji për Financat Komunale. Kështu që Kuvendi i Komunës ka mundësi që të ridestinoj deri në 5% të mjeteve financiare nga kategoritë e ndryshme siq janë Shërbime dhe Mallra, Administratë, Arsim, Shëndetësi aty ku realisht edhe nevoiten që këto mjete për me u shpenzuar. Kryesuesja e përmendi që Shtabi Emërgjent ka kërkuar që shuma e mjeteve të dyfishohet nga 100,000.00€ në 200,000.00€ mirëpo unë qëndroj pranë propozimit që kemi dhënë për ndarjen e 100,000.00€ sepse tani për tani mendoj se do të na mjaftojnë, dhe nuk

kemi nevojë të shkojmë në kuotën maksimale, shto këtu edhe faktin se kemi edhe donacione. Kjo pako financiare unë mendoj se do të na shërbej mjaftueshëm deri në muajin Maj. Mjetet financiare që janë propozuar të ndahen do të shfrytëzohen kryesisht për furnizimin e QKMF-së por edhe njësisive tjera me paisje mbrojtëse e dezinfektuese ndaj Koronavirusit, si dhe furnizimin me barna esenciale, pastaj shpërndarja e pakove ushqimore e higjienike për familjet më në nevojë, si dhe projekte të tjera për dezinfektim, këto ishin kërkesat fillestare të Shtabit Komunal të Emërgjencës. Ky Shtab i Emërgjencës është formuar më 13.03.2020 mbi bazën e Ligjit për emërgjenca si dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpalljen e Gjendjes shëndetësore emërgjente. Në këtë Shtab janë të përfshira të gjitha strukturat dhe institucionet, po ashtu janë formuar edhe 4 Nënshatabe të Emërgjencës, për fusha të caktuara që janë në komunikim të vazhdueshëm me Shtabin Komunal. Të nesërmen më 14.03.2020 është marrë vendim për mbylljen e objekteve që kanë qarkullim të madh të njerëzve si dhe ndalimin e organizimit të aktiviteteve sportive. Po ashtu është marrë vendim për ndarjen e disa pakove ushqimore për disa familje më nevojtare. Në mbledhjen e datës 15.03.2020 është hartuar një listë për donatorët e mundshëm, si psh. ELKOS me 200 pako etj. Kemi dhënë udhëzime për masat që duhet të respektohen. Në Komunën e Shtimes deri tash kemi pas vetëm një rast që është prekur me Koronavirus në fshatin Petrovë. Për fatin e mirë asnjë nga familjarët nuk është prekur. Edhe ky i prekur tani ka përmirësime të dukshme në bazë të testit të parë që ka rezultuar negativ. Nuk kemi indikacione që ka ndonjë rast tjetër në komunën tonë. Për këtë arsye sot kemi tërhequr Karantinën e vendosur para disa ditësh në lagjen Hysenaj të fshatit Petrovë. I falënderojmë furrat e bukës që kanë shprehur dëshirë për me i furnizuar 80 familje me bukë për një muaj. Shtabi emërgjent është aktiv 24 orë në ditë. Kemi ndërtuar një platformë që komunikojmë rregullisht me QKMF-në. Kështu pra ne e kemi propozuar këtë Vendim për ndarjen e njëqind mijë eurove si pako ku kemi menduar se deri në fund të muajit Maj do të mund ti përballojmë nevojat e QKMF-së, të familjeve në nevojë, si dhe nevojave të shërbimeve publike të domosdoshme. Për secilin shpenzim të kësaj pako do të udhëhiqet procedurë e njejtë e shpenzimit, por vetëm me një procedurë të përshtetshme. Sa i përket raportimit për shpenzimet nga kjo pako, ju do ta keni një raport të veçantë për të gjitha shpenzimet që janë bërë nga kjo pako e ndarë, nga Kuvendi. Meqenëse rishikim të Buxhetit nuk mund të kemi para përfundimit të tremujorit të parë, ne pra sot kur kemi hy në ditën e parë të muajit të katërt Prill, kështu që kemi thirrë mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit për mos me shkelë Ligjin e financave. Sa i përket kërkesës për heqjen e taksës për biznese, kjo taksë për biznese është hequr më herët, taksë ka vetëm sa i përket shfrytëzimit të terasave në hapsirat publike, por që ato tani nuk po shfrytëzohen për shkak të motit dhe situatës që jemi prandaj edhe mendoj se nuk ja vlen që të diskutohet sot për te.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Perparim Ramusa; Përshëndetje, diskutimin tim po e filloj me një lajm të mirë, pacienti nga petrova i prekur me Virusin Korona tani më është shëruar dhe në testin e parë ka rezultuar negativ, pritjet të bëhet edhe testi i dytë dhe pacienti të lirohet në shtëpi si i shëruar. Ne e përkrahim këtë propozim-vendim të kryetarit. Kisha kërkuar që Shtabi emërgjent të zgjerohet më shumë me punëtorë shëndetësor. Apeloj te Shtabi që mjetet financiare të ndahen më shumë te sigurimi i mjeteve mbrojtëse siq janë dezinfektues të ndryshëm, rroba e paisje, shujta ushqimore për punëtorët shëndetësor që punojnë nga 24 orë. Është për ta përshëndetur edhe mobilizimin e bizneseve në këtë situatë të pandemisë dhe ndihmën që kanë bërë. Apeli im do të ishte për qytetarët që të rrinë në shtëpi dhe të mbajnë distancën e nevojshme.

z. Fehmi Hysenaj; E falënderoj Kryetarin për ekspozicionin. Kryetari tha se Shtabi ka propozuar unanimitisht që pakaja të jetë 200.000,00€ ndërsa tash kur Kryetari po thotë që unë qëndroj pranë propozimit që kemi dhënë për ndarjen e 100.000,00€, po del që Shtabi nuk ka vendosur unanimitisht, sepse Kryetari nuk ka qenë "Për". E mira është që nuk jemi të rrezikuar nga ky virus, edhe pacienti i vetëm që ka qenë nga komuna jonë tani më po shërohet. Ka vend që të paraqesim edhe dilemat tona sepse dikush mundohet që edhe në këtë situatë të keqpërdorë mjetet buxhetore. Unë nuk dua që të thyhen procedurat. Në nenin 91 thuhet që Kryetari e harton Planin për reagim të shpejtë. Nëse i shohim se sa kanë ndarë mjete komunat tjera të cilat janë edhe më të mëdha se komuna jonë e shohim

se ne po ndajmë një shumë mjaft të madhe, psh. Komuna e Vitisë i ka nda 100,000.00€ pastaj Lipjani si komunë më e madhe i ka nda vetëm 50.000,00€. Prandaj unë po them që edhe shuma prej 100,000.00€ është e madhe, mirëpo edhe përkundër kësaj unë jam që të aprovohet. Nëse ka nevojë ne do të tubohemi prap në far do forma, vetëm për mos me i lënë keq nevojtarët në këtë situatë pandemie. Unë kërkoj nga qytetarët që të rinë në shtëpi, dalja të bëhet vetëm në rastet e domosdoshme.

z.Reshat Mujota; Përsëndetje, për të gjithë, në veqanti për Mjekët, Policët dhe të gjithë ata që po i kryen detyrat e domosdoshme për funksionimin e jetës. Unë kam një pyetje për Kryetarin në kuadër të Shtabit Emërgjent, se a është menduar që tu ndihmohet edhe familjeve që realisht nuk marrin asistencë Sociale por që vërtetë i kanë punët keq në këtë kohë të përhapjes së Virusit Korona?

z.Ruzhdi Jashari; Përsëndetje, edhe për ju edhe për qytetarët por edhe për ata që sot janë në vijën e parë të frontit me sëmundjen e Koronavirusit. Sot pra jo vetëm vendi ynë por gati e gjithë bota është atakuar nga një armik i pa dukshëm që tani më po njihet me emrin Koronavirusi. Ne sot jemi takuar në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit për të diskutuar për Propozim-vendimin e ekzekutivit për ndarjen e 100,000.00€ me i vu në shërbim të mbrojtjes dhe parandalimit të përhapjes së Virusit korona. Sa i përket mbajtjes së mbledhjes ne kemi dhënë mendimin tonë për mbajtjen e mbledhjes On-Line. Nëse shikojmë Komunitat siq janë Ferizaji, ka nda 200,000.00€ pastaj Viti 100,000.00€ Lipjani 50,000.00€ e që janë komuna më të mëdha se Shtimja. Ne po shprehim shqetësimin tonë që nuk kemi një arsyetim të specifikuar se ku do të shpenzohen këto mjete. Secilës kërkesë duhet ti paraprinë një plan paraprakisht i hartuar dhe i specifikuar psh. sa pako ushqimore nevoiten etj. dhe ky specifikim është dashur të na vinë në formë të shkruar me ftesën për mbledhje, e që nuk na kanë ardhur. Asnjë situatë nuk e largon Kryetarin nga raportimet që duhet ti bëj për secilin shpenzim që është bërë. Kërkoj nga qytetarët me qëndruar në shtëpi. Kam shpresë se këtë gjendje do ta kalojmë mirë. Ne do ta mbështesim këtë pako por do të kërkojmë raport për secilin shpenzim të bërë. Propozoj që në Shtabin Emërgjent të përfshihet edhe një përfaqësues i Pensionerëve, me arsyetimin se janë shtresa më e atakuar nga gripi KOVID19.

znj.Arbresha Syla; Përsëndetje, unë do të diskutoj shumë shkurt në aspektin profesional. Fillimisht e falënderoj Kryetarin si dhe donatorët që po bëjnë një punë të madhe në mbështetjen dhe ndihmat që i janë dhënë stafit shëndetësor në QKMF-ë. Gripi Korona, është një Pandemi tash më e shpallur nga OBSH-ja të cilën duhet trajtuar seriozisht e jo të bëhet hajgare me të. Në komunën e Shtimes institucionet shëndetësore ofrojnë shërbime për pacientë pavarësisht situatës, por këto shërbime normalisht që nuk mund të merren sikurse më parë, dhe kjo për faktin se nuk është e nevojshme të rrezikohen nga infektimi. Prandaj lutem të gjithë qytetarët që të rrinë në shtëpi, të respektojnë distancën e nevojshme prej 2 metrave. Shqetësim për stafin shëndetësor është se ka pas raste kur pacientët nuk i raportojnë realisht simptomat e tyre si dhe nuk tregojnë vendqëndrimin e tij të ditëve të fundit, këto janë t; rrezikshme jo vetëm për pacientin vetë por edhe për familjen edhe për rrethin që mund ti infektojë. I lusim pacientët që mos ti mshëfin simtomat sepse kjo vetëm sa e përkeqëson situatën edhe të pacientit por edhe të tjerëve. Lajmi i mirë është që në komunën tonë kemi vetëm një të sëmurë, dhe janë shenjat e mira për shërimin e tij. QKMF-ja është në dispozicion 24 orë për qytetarët. Dalja nëpër markete për tu furnizuar të bëhet vetëm nga një familjarë. Unë besoj se do të ja dalim mirë.

z.Skender Hyseni; Përsëndetje, u thanë gati të gjitha, kështu që unë nuk do ta zgjati shumë, por kërkoj që në këto momente të punojmë së bashku sepse jam i bindur që do ta kalojmë më mirë dhe më lehtë këtë sëmundje. Unë e pranoj pakon që e ka propozuar Kryetari, se sa dhe si do të shpenzohen këto mjete do ta shohim, mirëpo unë nuk besoj se dikush do ti keqpërdorë këto mjete në këtë situatë. I lus kolegët nga fusha e biznesit, që kanë më shumë mundësi për të ndihmuar, tani është koha që ta bëjnë. Është mirë që në komunën tonë kemi pas vetëm një rast, që tani ka informata se po shërohet. Unë besoj se do ta kalojmë me një mobilizim të të gjithëve.

z.Besnik Seferi; Përsëndetje, i falënderoj të gjithë ata që po kontribuojnë në këto momente për parandalimin e pandemisë KOVID19. Unë kam një propozim konkret për sa i përket përbërjes së Shtabit Komunal Emërgjent, që në përbërjen e tij të jetë edhe një përfaqësues nga opozita, pse jo, qëllimi është që të jemi të informuar sa më mirë.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, e falënderoj Kryetarin për informatën. Unë më parë thash se e përkrahu propozimin për ndarjen e 100,000.00€ për parandalimin e këtijë gripi i njohur si Koronavirus. I falënderoj po ashtu edhe donatorët që po kontribuojnë. Kështu që unë kërkoj nga kolegët përkrahje që ta kalojmë këtë pako, ishalla situata nuk përkeqësohet, por nëse ndodhë një gjë e tillë ne si Kuvend jemi këtu për të marrë masa shtesë. Unë nuk besoj që këto mjete mund të keqpërdoren në këtë situatë.

z.Isak Muslija; Faleminderit për informatën. Unë mendoj se është problem të reagohet në këto situata edhe nëse i kemi planet e gatshme. Siq e dini Komuna e ka Zyrën për Emërgjencë, mirëpo ajo nuk ka vijë të ndarë buxhetore, tani unë nuk e di se sa po funksionon dhe a ka ndonjë plan lidhur me një situatë të tillë të përhapjes së pandemisë KOVID19. Është gabim të qeveriset pa një drejtori për mbrojtje dhe emërgjencë, prandaj unë po kërkoj prap që në kuadër të drejtorive komunale të kemi edhe drejtorinë për emërgjencë.

z.Shefki Dauti; I falënderoj qytetarët që kanë qenë në nivel të detyrës. Po ashtu i falënderoj edhe institucionet publike që po i kryejnë punët e tyre. Ky fond prej 100,000.00€ do të siguroj që të kemi një situatë më të favorshme në parandalimin e përhapjes së koronavirusit. Në këtë pako do të ketë material medicinal për shëndetësi, si maska, dezinfektues, e paisje tjera mjeksore por do të ketë edhe ndihma për nevojtarët siq janë pako ushqimore. Uroj që këtë sëmundje ta kalojmë sa më lehtë dhe sa më mirë, mirëpo nëse paraqitet nevoja ne mund të tubohemi sërish për të ndarë mjete shtesë.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, e falënderoj Kryetarin për Informatën. Edhe unë e përkrahu propozim-vendimin për ndarjen e 100,000.00€ si pako për të intervenuar në parandalimin e Koronavirusit. Për këtë arsye i ftoj kolegët që ta aprovojmë këtë pako.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e Jashtëzakonshme për vitin 2020 e mbajtur më: 01.04.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare Buxhetore në shumën prej 100,000.00€ (njëqind mijë euro) për parandalimin e përhapjes të sëmundjes (Pandemisë) e quajtur Korona-Virusi (KOVID-19).**

Mjetet financiare të ndara do të merren nga programet Buxhetore si vijon:


1. Programi 16307 - Administratë dhe Personel, shuma prej 50,000.00€,
2. Programi 73450 - Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale, shuma prej 20,000.00€,
3. Programi 93180 - Arsim dhe Shkencë, shuma prej 30,000.00€

Kjo shumë e mjeteve financiare do ti kthehet Buxhetit të vitit fiskal 2020, përmes bartjes së të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti paraprak 2019.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Unë vetëm desha të ju falënderoj për miratimin e këtijë vendimi. Po ju them se kemi nevojë për secilin prej jush. Në Shtabin Komunal për emërgjencë sigurisht që do të plotësohet edhe me një anëtarë nga opozita. Ne do të ju kontaktojmë rregullisht dhe do të ju mbajmë të informuar, po ashtu zotohemi se asnjë familje nevojtare nuk do të jetë pa ndihma me pako ushqimore. Ju bëj me dije po ashtu se ne e kemi një plan për këtë. Ju siguroj se për shpenzimin e këtyre mjeteve, do të raportojmë me një raport specifik me aprovimin e auditorit. Në fund dua të apeloj te qytetarët që të qëndrojnë në shtëpitë e tyre, dhe të respektojnë masat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës dhe OBSH-së.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Apelit për të qëndruar në shtëpi i bashkangjitem edhe unë, dhe apeloj të respektojmë masat e ndërmarra, me shpresën se do ta kalojmë edhe këtë situatë të pandemisë KOVID19. me këtë apel edhe po e përfundoj mbledhjen e jashtëzakonshme në ora 11.35h

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

